

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2009

Duke konsideruar se:

- Zgjedhjet e lira dhe të ndershme përbëjnë themelin e shtetit dhe të demokracisë në çdo vend;
- Nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe të ndershme arrihet legjitimiteti dhe stabiliteti i jetës politike të vendit dhe nxitja e domosdoshme në rrugën e integritit europian;
- Procesi zgjedhor nuk është ekskluzivitet dhe përgjegjësi vetëm e institucioneve zgjedhore, por edhe rezultat i kontributit të përbashkët pozitiv dhe ligjor të të gjithë aktorëve dhe partive politike në vend;
- Pushteti ligjvënës duhet të krijojë dhe të mundësojë administrimin e zgjedhjeve nëpërmjet një legjislacioni demokratik, të standardeve ndërkombëtare dhe të realizuar në kohë, me qëllim që të mundësohet administrimi i tyre i drejtë;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

- Zgjedhjet e 28 qershorit 2009 kanë qenë zgjedhjet më të mira, më të drejta dhe më të lira që ka realizuar Shqipëria pas viteve 90-të dhe se zgjedhjet e 28 qershorit 2009 përmbushën shumicën e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë ndaj OSBE-së;
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në realizmin e këtyre zgjedhjeve, ka pasur rolin e tij të dukshëm dhe përcaktues për to;
- Pavarësisht kufizimeve të mëdha kohore, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i përgatiti dhe i administroi zgjedhjet me profesionalizëm, si dhe ndërmori një sërë hapash për rritjen e transparencës së procesit zgjedhor;
- U realizua një pasqyrim i balancuar i veprimtarive të të gjitha subjekteve zgjedhore në media, në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor;
- Procesi zgjedhor i qershorit 2009 shënoi hap cilësor në rritjen e transparencës, jo vetëm për sa i përket rolit të aktorëve politikë në to, por edhe pasqyrimin të procesit të numërimit, nëpërmjet kamerave dhe sistemit *on line* të lidhjes me KQZ-në; KQZ-ja e administroi me profesionalizëm dhe sukses këtë proces, duke realizuar njëkohësisht edhe vendosjen e standardeve të reja të transparencës zgjedhore në Shqipëri;
- Shpallja e vazhdueshme dhe në kohë e rezultateve paraprake nga KQZ-ja rriti transparencën e procesit dhe ishte një burim i besueshëm informacioni;
- Apelimet gjatë periudhës parazgjedhore dhe asaj paszgjedhore u shqyrtuan nga KQZ-ja në mënyrë profesionale dhe të drejtë, duke u dhënë atyre zgjidhje efektive;
- Deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, për herë të parë në historinë e zgjedhjeve parlamentare në Shqipëri, janë shpallur me konsensusin e plotë të të gjithë anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kuvendi kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2010:

- Fillimin e menjëhershëm të punës, brenda kornizës ligjore aktuale, për përgatitjen e zgjedhjeve vendore të radhës në vitin 2011, me qëllim realizimin e tyre në përmbushje të plotë të standardeve ndërkombëtare;
- Përpunimin e akteve nënligjore, në kompetencë të KQZ-së, në përputhje me rekomandimet e dhëna në raportin përfundimtar të zgjedhjeve nga OSBE/ODIHR-i dhe organizmat e tjerë ndërkombëtarë;
- Raporti përfundimtar i OSBE/ODIHR-it për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2009 të përbëjë dokument dhe një plan veprimi pune, për të përmirësuar të gjitha ato aspekte të veprimtarisë së KQZ-së, për të cilat është kërkuar përmirësim;
- Nxitjen e një klime të përshtatshme dhe të mëtijshme bashkëpunimi dhe konsensusi brenda anëtarësisë së KQZ-së, me qëllim rritjen e fizionomisë dhe vendimmarrjes teknike të saj, larg praktikave të pengimit dhe bllokimit të veprimtarisë së saj dhe administratës zgjedhore;
- Ndërgjegjësimin e zgjedhësve për ushtrimin e së drejtës së tyre kushtetuese, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare.

1 prill 2010